

VENDIM
Nr.6, datë 19.1.2011

**PËR RINOVIM LICENCE PËR EFEKT TË NDRYSHIMIT TË DREJTUESIT LIGJOR
DHE TEKNIK “ELBER” SHPK**

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë.....” Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca e operatorit “Elber” sh.p.k. me:
 - drejtues ligjor: z.Ardjan Sotir Zhidro;
 - drejtues teknik: z.Astrit Hasan Mënalla.
2. Operatori: “Elber” sh.p.k. autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:
 - Kategoria A, për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.
 - Kategoria C, për largimin e ujërave të ndotura.
3. Zona e shërbimit të këtij operatori është: bashkia: Elbasan
komuna: Bradashesh.
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare, deri në datën 19.1.2015.

KRYETARI
Avni Dervishi